



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Integritit Europian
Ministarstvo za Evropske Integracije - Ministry of European Integration

07 Prill 2011

Takimi i Kryeministrit dhe Kryetarëve të Komunave rreth procesit të ri-integrimit të personave të riatdhesuar

Prioritetet për ri-integrimin e personave të riatdhesuar (me fokus në përgjegjësitë e Komunave)

1. Finalizimi dhe miratimi i Termave të Referencës dhe përshkrimeve të vendeve të punës për Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete (qershor 2011);
2. Komunat të sigurojnë që sa më shpejtë që të jetë e mundur të implementohen Termat e Referencës dhe përshkrimet e vendeve të punës për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (shtator 2011);
3. Përfundimi i Trajnimeve për Trajnerë (ToT) për zyrtarët relevantë të nivelit qendror, të cilët do të merren me trajnimin e zyrtarëve relevantë komunalë (prill 2011);
4. Të hartohet një plan i hollësishëm trajnimi, i cili do të parashohë në hollësi numrin dhe temat e trajnimeve për Komunat, si dhe kategoritë dhe numrin e përafërt të zyrtarëve komunalë të cilët do të trajnohen (fillimi i majit 2011);
5. Përfundimi i ciklit të parë të trajnimit të zyrtarëve relevantë komunalë (ZIE, ZKKK, Drejtorive të Administratës, Arsimit, Shëndetësisë, Zyrave të Gjendjes Civile dhe të Regjistrimit Civil, Qendrat Komunale të Punësimit dhe Shërbimeve Sociale, etj) (maj 2011);
6. Vizita pune në të gjitha Komunat, me qëllim të vlerësimit të kapaciteteve të institucioneve dhe zyrtarëve përkatës për ri-integrimin e personave të riatdhesuar, si dhe sigurimit të raportimit adekuat, gjithëpërfshirës dhe me kohë nga ana e të gjitha Komunave (pjesa e parë e qershorit 2011);
7. Mision vlerësues i Komisionit Evropian, me fokus në kapacitetet e Komunave për ri-integrimin e qëndrueshëm të shtetasve të riatdhesuar (pjesa e dytë e qershorit 2011);
8. Komunat të inkurajojnë kërkesat për financim nga Fondi për Ri-integrim përmes aktiviteteve sensibilizuese, (si për të riatdhesuarit ashtu edhe për Komunat), gjithmonë duke respektuar maksimalisht kriteret për shfrytëzimin e këtij fondi si dhe legjislacionin relevant (qershor 2011);
9. T'u mundësohet regjistrimi pa vonesë në regjistrat e gjendjes civile i të gjithë shtetasve të riatdhesuar (Komunat të sigurojnë komunikim të vazhdueshëm me Zyrat Komunale të Gjendjes Civile dhe Zyrat

Komunale për Regjistrim Civil për të parë se a ka pengesa në këtë drejtim dhe të intervenojnë në rastet kur pengesat paraqiten) (në vazhdimësi);

10. T'u mundësohet regjistrimi pa vonesë në shkolla të gjithë fëmijëve të riatdhesuar (Komunat të sigurojnë komunikim me të gjitha shkollat në komunat e tyre për të sensibilizuar Drejtorët e shkollave rreth Udhëzimit Administrativ të MASHT-it që obligon regjistrimin e nxënësve në shkolla sapo të kthehen në vendbanimet e tyre, pa marrë parasysh vonesat në regjistrimin e tyre në zyrat e gjendjes civile), si dhe t'u ofrohen kurse të gjuhëve vendore të gjithë atyre fëmijëve që kanë nevojë për të mësuar gjuhën amtare apo atë të shkollës në të cilën do të vijojnë mësimin;
11. T'u mundësohet regjistrimi të gjithë shtetasve të riatdhesuar në Qendrat Komunale për Punësim dhe Trajnime Profesionale dhe ato të Shërbimeve Sociale (Komunat të sigurojnë komunikim me qendrat për punësim dhe ato për trajnim në komunat përkatëse);
12. Personave të riatdhesuar t'u sigurohet qasje e papenguar në shërbimet shëndetësore (Komunat të sigurojnë komunikim të vazhdueshëm me institucionet publike shëndetësore, si Shtëpitë e Shëndetit e të tjera, në komunat përkatëse);
13. Në bashkëpunim me AKP, të gjenden objekte të përshtatshme banimi nga skema e qiradhënies për personat e riatdhesuar që kanë nevojë për to dhe që plotësojnë kriteret për përfitim nga Fondi për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar, në pajtim me Strategjinë, Planin e Veprimit dhe kriteret për përfitim nga ky fond, prandaj është e domosdoshme që të gjithë zyrtarët komunalë relevantë të jenë të kualifikuar mirë dhe profesionalë në zbatimin e kriterëve për përfitim, si dhe të tregohen eficientë në kryerjen e të gjitha procedurave relevante, në komunikim të drejtpërdrejtë me Zyrën e MBP-së për Ripranim (në vazhdimësi);
14. Komunat të sigurojnë që ZKKK-të dhe ZKIE-të përkatëse të luajnë rol ndërlidhës me zyrat lokale të Agjencisë Kosovare të Pronës për rastet e pronës së uzurpuar në pronësi të personave të riatdhesuar;
15. Komunat të sigurojnë që ZKIE-të dhe ZKKK-të relevante të sigurohen që të monitorojnë dhe raportojnë në mënyrë të vazhdueshme te niveli qendror mbi të gjitha të arriturat në procesin e ri-integrimit të personave të riatdhesuar, përfshirë statistikën për personat e riatdhesuar dhe koston financiare;
16. Të mbahen takime periodike me personat e riatdhesuar në nivel komunal (Komunat të ftojnë personat e riatdhesuar një herë në tre muaj, që t'i informojnë ata mbi planet e Komunave dhe të informohen mbi problemet me të cilat përballen ata në procesin e ri-integrimit.